



Republika e Kosovës - Komuna e Suharekës
Republika Kosova- Opstine Suvareka
Republic of Kosovo-The Municipality of Suhareka



**Procesverbali nga Dëgjimi Publik me banorët e fshatit Vraniq, Popolan
për Kornizën Afatmesme Buxhetore 2027-2029**

Dëgjimi buxhetor me banorët e fshatrave Vraniq dhe Popolan u mbajtë më: 21.05.2026 në SHFMU “Dëshmorët e Kombit” në Vraniq, Komuna Suharekë, me fillim në ora 19:00.

Dëgjimin e shpalli të hapur Kryetari i fshatit, z. Tahir Kolgeci, i cili përshëndeti pjesëmarrësit dhe stafin Komunal të përbërë nga: Kymete Bajraktari-Drejtoreshën për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale si dhe Florinda Isufaj-Zyrtare Ligjore në DSHPE.

Kymete Bajraktari- Drejtoresha për Shëndetësi dhe Mirëqenie Sociale, përshëndeti dhe falenderoi pjesëmarrësit, duke filluar me prezantimin e Planifikimit Buxhetor për vitin 2027-2029. Ajo theksoi se ky takim është organizuar për të ndëgjuar kërkesat dhe nevojat e qytetarëve për shqyrtim të mëtejshëm.

Tahir Kolgeci-Kanalizimi nga qendra e fshatit deri tek shetitoret është jofunksional.

- Nuk ka ujë të pijshëm
- Trotuari nga shkolla deri tek udhëkryqi (trafoja) “Martirët e Vraniqit” me “Udhën e Shkronjave”
- Lagja Shehu-ndriqim publik
- Lagja e Rraqve-ndriqim publik
- Rruga fushore-ndriqim publik

-Januz Kolgeci-Kanalizim

- Tek rruga Dyrrahu që lidhet me rr. e “Ogushve” po dëmtohet rruga për shkak të ramjes së ujit.

Hazir Muqa- Të vazhdohet me ndërtimin e rrugës fushore si dhe pjesa e ndërtuar rreth 1000 m të shtrihet rrjeti i ndriqimit publik.

- Ujë të pijshëm

Skender Rraqi-Përfaqësues i lagjes:

- Nuk ka ujë të pijshëm, kanalizim, nuk ka rrjet të ndriqimit publik, një pjesë e rrugës së Rraqëve pjerrësia e saj është e lartë, kërkojn të sanohet nga kubëza me asfalt, pasi që ka vështirësi në qarkullim gjatë sezonës dimërore (bore, ngrica).

Dafina Kolgeci-asambleiste nga fshati Vraniq, falenderon kryesin e fshatit, pjesëmarrësit, stafin komunal dhe pajtohet me të gjitha kërkesat e parashtruara nga kryesia dhe banorët e fshatit sidomos për ujë të pijshëm, kanalizim, zgjidhja e problemit të varrezave në fshat.

Tahir Kolgeci së bashku me anëtarët e kryesisë falenderoi stafin komunal për bashkëpunimin e ndërsjellt.

Takimi përfundoi në orën : 20:10

Procesmbajtëse : Florinda Isufaj



Lista e pjesëmarrësve në dëgjime publike në VRANIQ

Date: 21.05.2026

Nr	Emri dhe mbiemri	Vendi	Nënshkrimi	Nr.tel
1	Jashir Kalycaj	Vranig	Jashir	049-229-181
2	Lajma Kulged	Vranig	Lajma	044/400-691
3	Skender Kragi	Vranig	Skender	049-343-991
4	JETHIR GRAXIU	VRANIQ	Jethir	049 666 551
5	Hazir R. Muxon	Vranig	Hazir	049/218-255
6	JANUZ KOCGOCI	VRANIQ	Januz	044 349-943
7				
8				
9				
10				
11				
12				
13				
14				
15				
16				
17				
18				
19				
20				
21				
22				
23				
24				